

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN ME MJEDISIN

**Rehabilitim sheshi, ndërtim
impianti per trajtimin e mbetjeve te
naftes dhe magazine per
depozitimin e materialit te trajtuar**

Kompania Zhvilluese:

BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD

Hartoi raportin:

GR ALBANIA SHPK



Rruga Sami Frashëri, Nr. 19, Hyrja Nr. 8,
1019 Tiranë, Albania
www.gralbania.com
info@gralbania.com

Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Nje Përshkrim te shkurtër të mbulesës bimore te sipërfaqes ku propozohet projekti, te shoqeruar dhe me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit;	5
2. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj; 9	
3. Një Identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;.....	11
4. Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;	17
5. Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;	19
6. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;.....	20
7. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitim;	22
8. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;	24
9. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka të tilla);.....	25

Lista e figurave

<i>Figura 1: Foto të gjendjes ekzistuese</i>	<i>5</i>
<i>Figura 2. Harta e burimeve hidrike</i>	<i>7</i>
<i>Figura 3: Largesitë e projektit nga rezervuari i Roskovecit dhe Lumi Seman.....</i>	<i>8</i>

Lista e tabelave

<i>Tabela 1 : Ndikimet në biodiversitet</i>	<i>10</i>
<i>Tabela 2 : Ndikimet në ujë.....</i>	<i>14</i>
<i>Tabela 3 : Ndikimet në tokë.....</i>	<i>14</i>
<i>Tabela 4 : Ndikimet në ajër.....</i>	<i>15</i>

AKRONIME

Akronim	Spjegimi
BPAL	Bankers Petroleum Albania
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Hyrje

Një mjedis i paprekur është një bazë esenciale për jetën e përditshme dhe, për pasojë, shëndetin, mirëqënien, ekonominë dhe konkurrencën e Shqipërisë. Marrja e masave për të mbrojtur burimet natyrore dhe për t'i përdorur ato në mënyre të qëndrueshme, për të mbrojtur ekosistemet e qëndrueshme dhe për të ruajtur një shkallë të lartë të diversitetit biologjik dhe peisazhor, si dhe për të mbrojtur klimën dhe për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike në fund të fundit. Këto gjithashtu përfshijnë ujë të pastër dhe ajër, pjellorinë e tokës, mbrojtje kundër rreziqeve natyrore dhe një furnizim adekuat të energjisë dhe lëndëve të para.

Shoqëria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" identifikuar me NIPT K43128401L, synon reduktimin e mbetjeve të ndotura me hidrokarbure për një mjedis më të pastër. Projekti po ndjek të gjitha procedurat ligjore për tu pajisur fillimisht me Deklaratë Mjedisore e më pas për të ndjekur procedurën për tu paisur me leje mjedisi, duke aplikuar në portalin e-Albania, për MTM dhe AKM që janë dy institucionet vendimmarrëse.

Ky raport synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar, efektet lidhur me ndikimet në florën, faunën, ujin, emetimin e gazeve serë në atmosferë, shkarkimet në tokë, ujë, ndotjen akustike, si dhe cdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilesisë dhe qëndrueshmerisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të aktivitetit.
- Analizën e faktorëve pozitivë e negativë mjedisor, përcaktimin e masave zbutese për reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Projekti tenton përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë shfrytëzimit të tij. Për këtë problem u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vrojtime të ndryshme, si dhe të biodiversitetit.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerëzit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qëniet në tokë. Njerëzit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve

mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos dëmtohen por të jetë e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmonë me kuptimin e qartë që i përkufizon. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden në nëntokë. Mjedis është më gjithëpërfshirës, çdo gjë që na rrethon. Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësore të çrregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shterimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndet fosile si dhe shumë burime të tjera. Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njerëzor.

Kemi dy tipe të impaktit mjedisor:

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Në mënyrë që të shmangen këto probleme njerëzimi duhet të mesoj se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër vecse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë. Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë përbërësve dhe burimeve natyrore e njerëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk i pranon politikat të cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lënë gjeneratat e ardhshme me prespektivë më të ultë (të varfëra) dhe/ose rreziqe më të mëdha se të tonat. Teknologjitë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm përfshijnë kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjisë së riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kërkime shkencore.

1. Nje Përshkrim te shkurtër të mbulesës bimore te sipërfaqes ku propozohet projekti, te shoqeruar dhe me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit;

Zona ne fjale eshte nje zone naftembajtese e cila nuk mundeson zhvillim te larte te bimesise. Tokat bujqësore të punueshme, të degraduara dhe ato të abondonuara zenë afërsisht më shumë se gjysmën e sipërfaqes së rajonit të studimit. Në këto mjedise biodiversiteti është dëmtuar më shumë se në të gjithë ekosistemet e tjera. Plugimet e perseritura të këtyre tokave dhe pa masa mbrojtese kane cuar deri në dëmtime të përmasave të pandreqshme dhe aktualisht një pjesë e madhe e sipërfaqes së tokave bujqësore janë abondonuar. Ato fizikisht jane gerryer në përmasa të medha dhe në shume raste ka dale në sipërfaqe tabani shkëmbor. Në të gjithë këtë zonë vetëm rrallë mund të shohësh copëza vegjetacioni natyral të dominuara nga *Phlomis fruticosa*, rrallëherë nga *Quercus coccifera*, *Spartium junceum*. Më shpesh vihen re sipërfaqe të konsiderueshme të mbuluara nga *Rubus ulmifolius* (ferra) dhe *Paliurus spina-christi* (driza). Tregues të tjere të ketij degradimi jane perhapja ne nje shkalle te konsiderueshme e specieve te tilla si species invazive *Dittrichia viscosa*, dhe llojeve antropogjene *Asphodelus aestivus*, *Andropogon ischaemum*, *Erigeron canadensis*, etj.

Flora e tokave bujqësore është e varfër në lloje dhe monotone. Në habitate të tilla perfshihen shume hapësira të zonës fushore e kodrinore, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezatimit te diellit ose te hijezuara nga bimet e kultivuara. Numri i specieve ketu eshte i ulet dhe ato jane direkt te kercenuara nga veprimtaria e njeriut. Nga flora kriptogamike në këto habitate rritet rreth 1 % e numrit total te specieve. Kuptohet qe ne tokat e punuara, biodiversiteti bie ne menyre te ndjeshme, sidomos kur perdoren herbicidet.

Nga familjet fanerogamike me shkallë më të lartë përhapjeje dhe me një numër më të madh llojesh janë: *Asteraceae*, *Poaceae*, *Fabaceae*, *Cruciferae*, *Papaveraceae*, *Charyophyllaceae*, *Polygonaceae*, *Convolvulaceae* dhe *Primulaceae*. Speciet me frekuencë dhe sasi më të lartë në rreth 60% te rilevimeve janë *Dittrichia viscosa*, *Papaver rhoeas* apo lulkuqja dhe me pas do te përmendnim: *Avena sterilis*, *Lactuca seriola*, *Alopecurus myosuroides*, *Sinapis arvensis*, *Capsella bursa-pastoris*, *Sonchus vulgaris*, *Anagallis arvensis*, *Medicago lupulina* etj.





Figura 1, Foto të gjendjes ekzistuese të vendit ku do të ndërtohet projekti

Sic duket edhe nga fotot e mësipërme kemi të bëjmë me një vegjetacion, shumë a pak i hapur, i formuar nga shkurre përgjithesisht rreth 50 cm të larta, rrallë 1m. Stadi vegjetacional me mbizotërim të bezgës (*Phlomis fruticosa*) mbulon sipërfaqe të rëndësishme në këtë rajon. Përfaqëson një mikro-grupim të rendesishëm e ndërmjetës të të ashtuquajturave "*Phrygana*", të pasura me bimë mjaltese, mjekësore dhe eterovajore. Duhet theksuar fakti se gjatë procesit të degradimit nga një stad në atë pasardhës ulet në mënyrë të ndjeshme numri i specieve duke u dominuar gjithnjë e më tepër nga kserofitet, ndërkohë që dhe fauna reduktohet në mënyrë të dukshme. Është një vegjetacion, shumë a pak i hapur, i formuar nga shkurre përgjithesisht rreth 50 cm të larta, rrallë 1m. Me gjithë kushtet e vështira ekologjike përgjithësisht është e pasur në lloje, sidomos në ato vjetore, që lulëzojnë gjatë periudhës së rreshjeve të pranverës dhe të vjeshtës, duke pushuar gjatë verës. Elementët karakteristikë të florës së këtyre formacioneve krahas llojit dominant janë: *Erica arborea*, *E.manipuliflora*, *Cistus monspeliensis*, *C. incanus*, *C. salviefolius*, *Juniperus oxycedrus*, *Rosa sempervirens*, *Dorycnium hirsutum*, *Spartium junceum*, *Brachypodium pinnatum*, *Pteridium aquilinum*. Shoqërimi me drizë (*Paliurus spina – christi*) dhe badhër (*Asphodelus aestivus*) i karakterizuar përveç specieve të mësipërme edhe nga prania e specieve si: *Thymus capitatus*, *Juniperus oxycedrus*, *Phillyrea angustifolia*, *Salvia officinalis*, etj. Shoqërimi bimor *Cisto-Micromerietum*. Zona në studim është naftëmbajtëse, zonë kjo që BPAL e ka në shfrytëzim në bazë të një marveshje koncesionare (hidrokarbure) nga Albpetrol sha. Dhe si e tillë zona në studim nuk ka një bimësi të pasur, nuk ka bimësi të mbrojtur ose me status të veçantë. Në përgjithësi në vendin e ndërtimit të projektit ka vetëm bimësi barishtore. Zona ku do të zhvillohet projekti ka një sipërfaqe prej rreth 30000m² prej të cilave 40-50% janë të kontaminuara me hidrokarbure nga aktiviteti i operatorëve të mëparshëm në fushë!

2. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Zona e vendburimit përshkohet nga lumenjtë Seman e Gjanicë dhe nga përrenj me rrjedhje jo të qëndrueshme. Relievi disi i thyer nga një sërë kodrash, në mënyrë periodike gjatë kohës së rreshjeve të mëdha atmosferike ka kushtëzuar formimin e rrëkeve të parëndësishme që në fund të fundit do përfundojnë në rrjedhën e lumit Seman e Gjanicë. E gjithë fusha përshkohet nga një sistem kanalesh drenimi të rregullt të ndërtuar me fillimin e zbulimit dhe vënies në shfrytëzim të vendburimit. Këto kanale përfundojnë në kolektorin kryesor Roskovec - Hoxharë. Gjendja e këtyre kanaleve aktualisht është e kontaminuar. Vetitë litologjike të shtresave në kontakt me sipërfaqen bëjnë që edhe pse niveli i ujërave nëntokesore të jetë afer (në periudhën e verës rreth 2 m nga sipërfaqja dhe në dimer ky nivel ngrihet duke bërë që uji të vijë në sipërfaqe), ato të mos shfrytëzohen. Këto shtresa më përshkushmeri të ulët, vazhdojnë deri në thellësi të mëdha duke bërë normalisht të pandjeshme nga sipërfaqja ndotjen e shtresave ujore me interes shfrytëzimi komunal.




Figura 2, Harta e burimeve hidrike

Zona e projektit bën pjesë në basenin ujëmbledhës të lumit Seman i cili është një basen i varfër me ujëra nëntokësore. Në ndërtimin hidrogeologjik të zonës bëjnë pjesë këto komplekse ujëmbajtëse hidrogeologjike:

- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Kuaternarit
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Pliocenit të mesëm (N2 2 r)(suited "Rrogozhina")
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Pliocenit të poshtëm (N2 1h) (suited "Helmasi")

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të kuaternarit ka përhapje të gjerë në rajon, sidomos në gjysmen veriore të tij. Përbërja litologjike e tyre është kryesisht argjilore dhe argjilo-ranore. Të përfaqësuara nga aluvione të formuara nga veprimtaria e lumit Seman, që në rrjedhjen e poshtme të tij, ku përfshihet zona e studimit janë kryesisht fraksione të imta. Trashësia e këtij kompleksi në pjesën verilindore të planshetit të Roskovecit, në sektorët pranë shtratit të lumit Seman, shkon deri në 50 m. Në drejtim të jugut trashësia e këtyre depozitimeve ulet deri në 5-10 m. Për vetitë hidraulike të këtij kompleksi nuk ka të dhëna të mjaftueshme, pasi ajo ka qenë një zonë tradicionale për zhvillimin e industrisë së naftës. Për të gjykuar mbi ujëmbajtjen e tij jemi mbështetur në analogjitë me pjesë të tjera të kompleksit të depozitimeve Kuaternare më në perëndim të zonës së projektit. Nga kjo analogji, si dhe mbështetur në hartën hidrogeologjike me shkallë 1:200000 të vitit 1985, mund të themi se kompleksi ujëmbajtës i Kuaternarit në zonën e studimit paraqitet me ujëmbajtje të ulët deri në shumë të ulët dhe pa ndonjë lidhje të rëndësishme me rrjedhën ujore të lumit Seman.




Figura 3, Largesitë e projektit nga rezervuari i Roskovecit dhe Lumi Seman

3. Një Identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;

Qëllimi kryesor i këtij raporti është identifikimi i ndikimeve që mund të shkaktohen gjatë gjithë fazave të projektit BPAL për ndërtimin dhe vënien në punë të impiantit të shpërthithjes termike për trajtimin e mbetjeve të naftës. Është shumë e rëndësishme të identifikohen dhe të vlerësohen karakteristikat e efekteve negative dhe pozitive në mjedisin fizik, biotik, social dhe ekonomik të zonës në të cilën do të zbatohet projekti. Impakti i procesit të vlerësimit i cili mundëson vlerësim të bashkëveprimit të projektit dhe mjedisit. Për më tepër, vlerësimi i ndikimit ndihmon në identifikimin e ndjeshmërisë së mjedisit të zonës ndaj projektit dhe masave zbutëse kundër ndikimeve negative të identifikuara në këtë zonë për ndërtimin e projektit në fjalë.

Ndikimet në biodiversitet

Flora

Zona në të cilën do të zhvillohet projekti është një zonë industriale e fragmentuar me parcela bujqësore. Flora e zonës ndikohet nga përdorimi i shumë dekadave nga bujqësia intensive dhe nga përdorimi i rezervave të naftës. Bimët janë tipike të ultësirës Mesdhetare dhe nuk ka prani të specieve të rralla që mbrohen me ligj. Gjithashtu, nuk ka ndonjë monument natyror dhe zona të mbrojtura brenda fushës së naftës Patos – Marinzë. Duke zbatuar politikën mjedisore dhe standardet ndërkombëtare, kompania ka rehabilituar shumë parcela toke, kanale kullimi dhe menaxhon çdo lloj mbetje të hedhur aksidentalisht ose jo, nga punetoret gjatë punimeve në fushën naftë mbajtëse Patos-Marinez. Funksionimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve hidrokarbure nuk do të emetojë dhe nuk do të shkaktojë ndikime negative në parcela bujqësore, në habitate natyrore dhe në florë. Në kanalet e ujitjes ose kullimit nuk do të shkarkohen mbeturinat, të cilat i japin fund rrezikut të kulturave. Gjithashtu, funksionimi afatgjatë i impiantit të shpërthithjes termike nuk lëshon ndotës që mund të grumbullohen në një mjedis dhe ta bëjnë të mos njihet pas shumë vitesh. Përkundrazi instalimi dhe funksionimi i impiantit të shpërthithjes termike do të shërbejë për eliminimin e mbetjeve të naftës duke bërë të mundur dhe rehabilitim të sipërfaqeve të zëna prej tyre ndër vite.

Fauna

Zona e projektit vlerësohet si zonë me lloje të faunës të egër të varfër sepse nuk ka habitate natyrore në zonën e Patos - Marinzës. Habitatet mbizotëruese në zonë janë industriale dhe bujqësore, dhe kjo është arsyeja pse në zonë mungon diversiteti. Brënda fushës së naftës të Patos-Marinzë nuk gjendet asnjë lloj habitati i specieve të rrezikuara dhe të mbrojtura, gjithashtu nuk ka zona të mbrojtura brenda saj. Gjatë fazës së ndërtimit, nuk do të ketë punime

në habitatet e mbrojtura ose të paprekura dhe për këtë arsye nuk do të ketë burime nga të cilat do të shkaktohen dhe do të emetohen ndikime negative. Gjatë fazës së operimit të gjitha ndikimet negative që do të shkaktohen do të kufizohen brenda zones ku do të ushtrohet projekti. Gjithashtu, çdo vendndodhje e projektit do të funksionojë në bazë të standardeve dhe sigurisë të përcaktuar nga BPAL dhe do të sigurohet që asnjë faunë e egër nuk do të rrezikohet. Megjithatë vlen të theksohet se sipërfaqja e projektit të propozuar është e kontaminuar nga aktiviteti i ushtruar nga operatori i mëparshëm përpara se t'i dorëzohet për përdorim BPAL. Për këtë arsye, BPAL përpara zhvillimit dhe implementimit të projektit të propozuar ka planifikuar rehabilitimin e plote të sipërfaqes së kontaminuar. Rehabilitimi i sipërfaqes së kontaminuar është aktivitet pjesë e këtij projekti për të cilin po ndërmerret edhe procedura e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Tabela1. Ndikimet në biodiversitet

Biodiversiteti		
	Ndikimet gjatë ndërtimit	Ndikimet gjatë funksionimit
Flora	<p>Projekti do të zbatohet në zonën industriale / naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Vendi i ndërtimit të projektit do të jetë brënda bllokut në të cilin ushtron aktivitetin kompania Bankers Petroleum Albania Ltd.</p> <p>Gjatë fazës së ndërtimit të këtij projekti nuk do të ketë ndikime që të ndikojnë në florën e zonës, ndikimet gjatë kësaj faze do të jetë të përqëndruara dhe me një shtrirje të vogël lokale vetëm në zonën e projektit.</p>	<p>Gjatë fazës së funksionimit të projektit në fjalë nuk do të ketë ndikime negative në biodiversitet.</p> <p>Nuk do të ketë shkarkimin e asnjë elementi që mund të ndikojë në florën, për vet faktin që i gjithë procesi i impiantit të shpërthithjes termike është i mbyllur dhe me shkarkime minimale. Nëse gjatë monitorimeve në terren do të vihen re shkarkime jashtë normave, të cilat mund të ndikojnë në florën dhe faunën e zonës do të merren masa të menjëhershme duke ndërprerë dhe procesin e punës, deri në gjetjen e një zgjidhje.</p>
	Ndikimet gjatë ndërtimit	Ndikimet gjatë funksionimit
Fauna	<p>Zona në fjalë nuk ka prani të kafshëve të egera, të mbrojtura me ligj apo me status të veçante, çka nënkupton që gjatë ndërtimit të këtij projekti nuk do të kemi asnjë lloj ndikimi në faunën e</p>	<p>Gjatë funksionimit të projektit të impiantit të shpërthithjes teknike nuk do të gjenerohet asnjë lloj ndikimi në faunën e zonës.</p> <p>Duke qënë se procesi teknologjik i</p>

	egër.	<p>impianitit të trajtimit të mbetjeve të naftës do të jetë me cikël të mbyllur nuk do të kemi emetime që mund të ndikojnë në fiziologjinë e faunës.</p> <p>Zona ku do të ndërtohet projekti monitorohet periodikisht nga Laborator të akredituar sipas kërkesave të vet kompanisë cka nënkupton që kompania është e ndërgjegjeshme dhe nuk lejon në asnjë moment të ketë shkarkime jashtë normave dhe që të bioakomulojnë në mjedis. Dhe të ketë ndikime në biodiversitet. Përkundrazi funksionimi i këtij impianti do të bej të mundur pastrimin e sipërfaqeve të ndotura me mbetje cka mund të ndikojë në shtim të biodiversitetit të zonës.</p>
--	-------	---

Ndikimi në ujera (sipërfaqësore dhe nëntokësore)

Identifikimi i ndikimeve negative u bazua në projektin teknologjik, materialin e parë bazë që nevojitet në procesin teknologjik dhe në emetimet në mjedis.

Projekti do të përdorë si lëndë ndihmëse ujë, i cili do të merret nga pusët që BPAL disponon brenda fushës ku ushtron aktivitetin dhe i ka të paisur me leje nga baseni përkatës. Dhe pse më së shumti në këtë linjë teknologjike për trajtimin e mbetjeve të ndotura me hidrokarbure ujë do të përdoret më shumë si ujë ftohës i cili do të jetë qarkullues. Ujrat që do dalin nga procesi i trajtimit ose do ripërdoren në impiant me riqarkullim dhe ose do të kalohet në sistemin e trajtimit të ujit që bëhet për ujin e prodhimit ose do të hidhet në gropën ekologjike 8 nëse nuk është i përshtatshëm. Si rrjedhojë në asnjë rast nuk do të ketë shkarkime në mjedis.

Përsa i përket ndikimeve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntoksore, nga zhvillimi i këtij projekti ato nuk preken pasi nuk do të ketë në asnjë rast shkarkim në ujera sipërfaqësore apo nëntokësore uji i përdorur do të kalojë nëpërmjet rrjetit të tubacioneve për në impiantin e trajtimit të ujërave për të cilin kompania BPAL është i paisur me leje ose do të shkarkohet në gropën ekologjike 8 nëse ai nuk do të jetë më i përshtatshëm.

Tabela 2. Ndikimet në uje

Ujë		
	Ndikimet gjatë ndërtimit	Ndikimet gjatë funksionimit
Ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore	Gjatë fazës së ndërtimit nuk do të ketë përdorim të ujit si rrjedhojë as ndikime në ujera.	Në këtë fazë ujë do të përdoret si ujë ftohës dhe është ujë qarkullues, pra nuk do të ketë shkarkime e si rrjedhojë as ndikime në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në rastet e gjenerimit të ujerave ato do të grumbullohen në një depozitë e cila më pas do të transportohet për në sistemin e trajtimit të ujit të prodhimit që subjekti disponon, ose do të shkarkohet në gropën ekologjike 8, duke mundësuar në këtë mënyrë sjelljen në mënyrë miqësore me mjedisit dhe duke mos shkarkuar asgjë në mjedis.

Ndikimet në tokë

Projekti për ndërtimin e magazinës dhe impiantit të trajtimit të mbetjeve të naftës (impianti i shpërthithjes termike) do të kryhet në një zonë brenda zonës së shfrytëzimit nga BPAL. Si rrjedhojë ndikimet të cilat do të ndodhin nuk priten të jenë të konsiderueshme për shkak se zona është me aktivitet ekzistues industrial. Në tokë do të ketë ndikim vetëm gjatë fazës së ndërtimit të magazinës e cila do të jetë me konstruksion metalik dhe mbulesë llamarinë.

Tabela 3. Ndikimet në tokë

Toka		
	Ndikimet gjatë ndërtimit	Ndikimet gjatë funksionimit
Toka	Gjatë fazës së ndërtimit, përgatitja e vendeve dhe instalimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për projektin, nuk do të ndikojnë në cilësinë e tokës. Në vendndodhje do të kryhen	Në këtë fazë përbërja e gjeneruar pas trajtimit të mbetjes do të vendoset në thase të medhenj dhe do të magazinohet në magazinën e ndërtuar enkas për këtë qëllim, kjo

	<p>disa punime te vogla ndërtimore si ngritja e strukturës për magazinën e cila do të jetë me konstruksion metalik. Pra ndikimi i vetem që është në tokë është zënia e hapsirës nga ndërtimi i magazinës dhe vendosja e impiantit të shperthithjes termike, pasi shkarkime të tjera nuk do të ketë.</p>	<p>përbërje ka përdorim të gjere në fushën e ndërtimit të rrugëve dhe jo vetëm prandaj për të është menduar magazinimi i mbrojtur nga agentët atmosferik dhe më pas të bëhet largimi i tij nëpër subjekte të interesuara sipas të gjithë rregullave e ligjeve në fuqi.</p> <p>Në tokë nuk do të ketë asnjë lloj shkarkimi, mbetjet e gjeneruara nga konsumi i punonjëseve do të grumbullohen fillimisht në kontener të posaçëm brenda aktivitetit dhe në fund të çdo dite pune do të largohen për në vendet e përcaktuara për këto lloj mbetje nga Pushteti Vendor.</p>
--	---	---

Ndikimet në ajër

Gjatë ndërtimit të magazinës dhe instalimit të impiantit të shperthithjes termike do të ketë gjenerim pluhurash në ajër dhe emetim të gazeve nga shkarkimet e motorëve të mjeteve të transportit dhe të punës që do të përdoren në këtë aktivitet. Per eliminim të tyre do të spërkaten ambjentet e punës me ujë në formë shiu pa krijuar rrjedha ujore sidomos në kohë të thatë dhe me erë. Dhe pse automjetet që do të përdoren janë të kontrolluara nga instancat përkatëse sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi. Kurse gjatë fazës së funksionimit të projektit oxhaku i impiantit është i paisur me filtra për kapjen e pluhurave dhe gazeve të diegies. BPAL gjithashtu kryen monitorime në bashkëpunim me laborator të akredituar për të gjithë zonën që ka në shfrytëzim sipas një periodiciteti të caktuar, çka nënkupton që është në kontroll të vazhdueshëm të cilesisë së ajërit në zonë.

Tabela 4. Ndikimet në ajër

Ajëri		
	Ndikimet gjatë ndërtimit	Ndikimet gjatë funksionimit
Cilesia e ajërit	Gjatë punimeve të ndërtimit të magazinës dhe instalimit të impiantit të shperthithjes termike do të shkarkohen gazra dhe pluhur në ajër nga levizja e	Ndotja e ajrit do të ekzistojë si rezultat i tymit dhe gazrave të shkarkuara nga automjetet dhe makineritë që frekuentojnë këtë aktivitet: gjeneratorët ne rast

	<p>mjeteve, por niveli i shkarkimeve është i papërfillshëm dhe me një shtrirje të vogël vetëm në zonën e projektit.</p>	<p>emergjence ose makinat e përdorimit të lëndëve djegëse fosile, si dhe gjeneratori elektrik dhe ai me avull që gjenerojnë emisionet si oksidet e karbonit, sulfurit dhe azotit, HC dhe PM.</p> <p>Gjithashtu edhe funksionimi i impiantit të shperthithjes termike do të emetoje në ajër por në nivele të ulëta, këto emetime do të kenë një shtrirje vetëm lokale dhe do të jenë në nivele të moderura.</p>
--	---	--

4. Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Shkarkimet në ujëra

Në këtë projekt nuk do të ketë asnjë lloj shkarkimi në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, ujerat e ndotura do të kanalizohen nëpërmjet tubacioneve dhe orientohen për në sistemin e trajtimit të ujit të prodhimit ose fillimisht do të magazinohen në një depozitë dhe më pas do të transportohet për në impiantin e trajtimit, dhe nëse do të jetë i papërshtatshëm do të shkarkohet në gropën ekologjike 8 (kjo sipas zgjedhjes së BPAL).

Sasia e ujit të nevojshëm do të sigurohet nga burimet nëntokësore që BPAL disponin dhe është i paisur edhe me lejet përkatëse nga Baseni. Nuk do të ketë përdorim të burimeve të ujit të pijshëm që përdoret në zonën përreth, dhe gjithashtu nuk do të ketë as shkarkime të lëngëta.

Shkarkimet në ajër (gaze dhe pluhura)

Cilësia e ajrit në fushën e naftës Patos-Marinzë varet nga shumë operacione industriale. BPAL kryen monitorimin e cilësisë së ajrit në një numër sheshesh të vendosura në të gjithë fushën naftëmbajtëse Patos-Marinzë për të siguruar një set të dhënash të përgjithshme për zonën. Monitorimi i ajrit që kryhet përfshin burimet të përzgjedhura të emetimit të ajrit dhe maten përkundrejt normave të lejueshme që përfshijnë operacionet BPAL. Ka shumë pika të sheshit ku kryhet monitorimi i ajrit. Përsa i përket projektit në fjalë shkarkimet në ajër do të jenë gjatë ndërtimit nga lëvizja e mjeteve të transportit që mund të shkaktojnë pluhura dhe nga motorrët e mjeteve nga lënda djegëse që këto mjete përdorin. Kurse gjatë fazës së funksionimit do të emetohen gaze në ajër nga oxhaku i linjës së trajtimit të mbetjeve por duke qënë se bëhet fjalë për një teknologji bashkohore impianti do jetë i paisur me filtra për kapjen e këtyre gazeve çka bën të mundur reduktimin e shkarkimeve në ajër.

Shkarkimet e zhurmës

Gjatë fazës së ndërtimit të magazinës dhe instalimit të impiantit për trajtimin e mbetjeve hidrokarbure do të ketë gjenerim zhurme nga aktiviteti ndërtimor për ngritjen e strukturës së magazinës dhe montimin e linjës teknologjike niveli i zhurmës do të jetë 60-65 dB. Burim tjetër zhurme mund të përmendim atë të shkaktuar nga lëvizja e mjeteve/makinerive të punës. Kurse gjatë fazës së funksionimit të projektit niveli i zhurmës do të jetë në nivele të ulëta pothuajse të

papërfillshme duke qënë së dhe zona ku do të ushtrohet aktiviteti është e distancuar nga zonat urbane.

Prodhimi i mbetjeve

BPAL disponon sipërfaqen, infrastrukturën, kapacitetet dhe forcën puntore të nevojshme për menaxhimin e mbetjeve të ndotura me hidrokarbure. Pra ky projekt konsiston në ndërtimin dhe operimin e një linje teknologjike e cila do të trajtojë mbetjet e ndotura me hidrokarbure të grumbulluara ndër vite nëpër gropa ekologjike brenda sipërfaqes ku subjekti ushtron aktivitetin në bazë të marrëveshjes koncesionare. Sa më sipër kemi të bëjmë me një aktivitet që do të trajtojë mbetje dhe jo që gjeneron, materiali i përfutur nga trajtimi i mbetjeve në impiantin e shpërthithjes termike do të futet në thase të mbedhenj dhe do të magazinohen në magazinën e ndertuar për këtë qëllim, e më pas do të jepet subjekteve të interesuara duke qënë se është një material që ka përdorim të gjerë në fushën e ndërtimit të infrastrukturës rrugore por jo vetëm, dhe për material baze për prodhimin e cimentos, fabrikim tullash etj. Gjatë ndërtimit të magazinës nuk do të ketë mbetje pasi objekti do të jetë me konstruksion metalik dhe i llogaritur në bazë të sipërfaqes për materialin e përdorur çka nënkupton mos gjenerim të mbetjeve. Mbetjet e vetme që mund të gjenerohen në këtë aktivitet janë ato me natyrë urbane të gjeneruara nga konsumi i përditshëm i punonjësëve të cilat do të grumbullohen fillimisht në kontener të posaçëm brenda zonës së aktivitetit dhe në fund të çdo ditë pune do të largohen për në vendet e caktuara për to nga Pushteti Vendor. Kurse përsa i përket mbetjeve të lëngëta ato ose do të magazinohen në një depozitë të vendosur në ambjentet e aktivitetit e më pas të transportohen për në impiantin e trajtimit ose nëpërmjet tubacioneve do të orjentojnë direkt për në impiantin e trajtimit që subjekti disponon.

5. Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

Qëllimi i vlerësimit dhe zbutjes së impakteve është identifikimi dhe vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të mundshme në receptorët dhe burimet e identifikuar sipas kriterëve të përcaktuar të vlerësimit, të përcaktojë kohëzgjatjen dhe shtrijen hapsinore të ndikimeve negative në mjedis e në bazë të tyre do të ndërmerren masat për të shmangur ose minimizuar çdo efekt negativ të mundshëm dhe për të rritur përfitimet e mundshme.

Një ndikim është çdo ndryshim në një burim ose receptor që vjen nga prania e një komponenti të projektit ose nga ekzekutimi i një aktiviteti të lidhur me projektin. Vlerësimi i të dhënave bazike siguron informacion thelbësor për procesin e vlerësimit dhe përshkrimit se si projekti mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe socio-ekonomik.

Ndikimet gjatë fazës së parë do të jenë prezente për sa kohë do të jete duke u ndërtuar projekti në fjalë këto quhen dhe ndikime të përkoheshme me impakt afatshkurter vetëm gjatë fazës së ndërtimit. Kurse gjatë fazës së dytë ndikimet do të jenë me të përqëndruara dhe do të jenë prezente për aq kohë sa do të vazhdojë të ekzistoj edhe aktiviteti në fjalë, vetëm se shtrirja e tyre do të jetë e përqëndruar vetëm brenda zonës së projektit dhe në nivele të moderuara, këto ndikime do të jenë afatgjata. Kjo do të tregohet në monitorimet që do të kryhen sipas periodicitetit të kërkuar.

6. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nenkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që perfshihen në të;

Një element bazë i domosdoshëm për realizimin e projektit, është ekzistenca e një infrastrukture bazë urbane, duke filluar nga rrugët automobilistike, furnizimi me ujë, , rrjetit të furnizimit me energji elektrike,. Nuk kemi ndikime negative të pakthyeshme për mjedisin ujor, për tokën, ajrin dhe biodiversitetin. Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative në mjedis vlerësohet të jetë prezente në zonën e projektit dhe zonat përreth tij. Pra është një ndikim i kufizuar vetëm në rang lokal.

Duke njohur teknologjinë, operacionet në terren dhe projektin që do të zhvillohet u indentifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptorë - përbërës të mjedisit në objekt.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i ndërtimit të magazinës dhe instalimit të impiantit të shpërthithjes termike dhe u indentifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptorëve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisorë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve. Vlerësimi i sinjifikancës ka të bëjë me vetë rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përafron atë me objektivisht me tërësinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve varrojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësinor të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që e gjeneron atë ndikim, p.sh. ndikimi në tokë nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit është një ndikim i cili nuk mund të matet.

Kohëzgjatja e ndikimit – Vlerëson se sa do të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkoshëm). Në rastin tonë ndërtimi i magazinës dhe mbulesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve të naftës është për një afat kohor të shkurtër vetëm gjatë fazës së ndërtimit. Ndërsa të gjitha ndikimet e tjera negative në mjedis janë të përkoshme, si shkarkimet në ujë, tokë, zhurmat, emetimet e pluhurave, etj.

Kthyeshmëria –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të më parëshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar)

Rëndësia – Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson vemëndjen që duhet patur për administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të madhe fizike, projekti ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zona më e afërt e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

Zhurmat që krijohen gjatë punimeve ndërtimore dhe operimit të impiantit të shpërthithjes termike nuk përbëjnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga paisjet dhe makineritë e punës tregon se ato ndodhen nën mesataren e frekuencës së pranueshme nga veshi i njeriut, zhurma e zhkaktuar do të jetë në nivele të moderuara rreth 60-65 dB. Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqënëse në objekt do punohet vetëm me një turn.

7. Mundesinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundesinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përaferta për rehabilitim;

BPAL është e angazhuar në menaxhimin e mjedisit përmes planifikimit, ndërtimit, operacioneve dhe rehabilitimit. Marrëveshja hidrokarbure përcakton se nuk ka kërkesë për mbylljen e këtyre objekteve deri në fund të koncesionit pasi që ato janë pjesë e infrastrukturës së prodhimit të naftës. Restaurimi i fushës së naftës Patos-Marinza është përshkruar në kontratën e koncesionit të BPAL dhe BPAL do të përmbushë kërkesat e kësaj kontrate. Ky sistem i menaxhimit përfshin aftësitë dhe veprimet përgjigjëse 24 orëshe, plane rehabilitimi, menaxhim të mbeturinave dhe kërkesat e mbylljes së objekteve të cilat janë të dizajnuara për të përmbushur standardet ndërkombëtare. BPAL do të vazhdojë të mbështesë aftësinë për të ricikluar, ripërdorur mbeturinat që gjenerohet në kuadër të fushave të naftës në përpjekjet për të bërë operacionet e BPAL-it në fushën e naftës në zero.

Funksionimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve të ndotura me hidrokarbure, është një nga hapat për rehabilitimin e gropave ekologjike.

Duke u nisur nga projekti në fjalë mjedisi i ndikuar nga zënia e strukturës (magazina) dhe vendosja e impiantit të shpërthithjes termike nuk mund të pretendojmë kthim të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, pasi ajo do të zihet nga struktura dhe impianti. Kurse përsa i përket sipërfaqes përreth ajo do të rehabilitohet sipas përdorimit, por nuk mund të themi që sipërfaqja e rehabilituar mund të përdoret në bujqësi, pasi kemi të bëjmë me një zonë industriale naftëmbajtëse.

Veprimet e rehabilitimit gjatë funksionimit, aktivitetet operative në të gjithë zonën e projektit kompania ka zhvilluar politika dhe procedura të dizajnuara për të siguruar:

- Mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjes
- Rehabilitimin e vazhdueshëm të kontaminimit të trashëgimisë, ku lejohen planet tona të zhvillimit;
- Sigurimi i kontrollit të rreptë të operacioneve të punës për të siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës;
- Raportimi i menjëhershëm dhe pastrimi i derdhjeve dhe shkarkimeve aksidentale të materialeve potencialisht të kontaminuara;

Pas përfundimit të projektit në fjalë, do të implementohet plani i rehabilitimit i cili konsiston në:

- Njoftimin e institucioneve përgjegjëse për çmontim të paisjeve
- Heqja e makinerive dhe paisjeve
- Heqja e strukturës sipërfaqësore/ çmontimi i impiantit të shpërthithjes termike
- Largimi i mbetjeve që mund të kenë ngelur në zonën në fjalë
- Inspektim vizual dhe analizë mjedisore e zonës pas çmontimit dhe largimit të paisjeve
- Aty ku është e mundur ndërhyrja për përmirësim
- Rehabilitim i zonës duke e kthyer atë të përdorshme për një tjetër projekt

8. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Masat zbutese të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjes gjatë zhvillimit të aktivitetit, në ajër, të pluhurave, gazeve dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore të territorit, faunën dhe florën. Por pikësnyimi i studimit mbetet trajtimi i mbetjeve të ndotura me hidrokarbure në impiantin e shpethithjes termike, rehabilitimi i mjedisve të prekura (gropat ekologjike) dhe evitimi në maksimum i ndotjes.

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis, masat që duhen konsideruar janë:

1. Gjatë fazës së ndërtimit të punohet me kujdes, dhe të mos krijohen mbetje nga ndërtimi;
2. Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike për të reduktuar mundësitë e rënies së zjarrit dhe avaritë në sistemin elektrik duke shmangur kështu edhe ndotjen e mjedisit, pasi mbetja është e ndotur me hidrokarbure që është e ndezëshme dhe mund të shkaktojë një ndotje masive të mjedisit nëse digjet;
3. Të vendosen postera sensibilizues për punonjësit dhe banorët për një mjedis të pastër;
4. Të bëhet sipas pozicionit të punës çdo detyrë e caktuar për punonjësit e aktivitetit;
5. Të krijohen kushte optimale punë për punonjësit në këtë aktivitet;
6. Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë kryerjes së proceseve të punës;
7. Të kryhet menaxhimi i mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos krijohen probleme mjedisore për mjedisin e zonës përreth.
8. Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi gjatë fazës së ndërtimit dhe më pas për funksionimin e projektit.

9. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka të tilla);

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Fusha e naftës Patos-Marinëz ndodhet brenda territorit të vendit tonë (Republikës së Shqipërisë) dhe nuk ka ndikime me natyrë ndërkufitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5069 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 502


ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Nj. DENISA KOLA

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 331 Prot.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.087Regj.


ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialiteteve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Sorilla LLUPO

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Ethem RUKA

